



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

ALEANCA E GRAVE DEPUTETE

RAPORT

PËR VEPRIMTARINË E GRUPIT TË DEPUTETEVE “ALEANCA E GRAVE DEPUTETE” PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2020

I. ORGANIZIMI I ALEANCËS SË GRAVE DEPUTETE (AGD)

Aleanca e Grave Deputete është një organizim vullnetar i grave ligjvënese të të gjitha grupimeve politike në Kuvendin e Shqipërisë. Aleanca e Grave Deputete ka në vëmendje të saj arritjen e objektivit që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në pushtetin vendor minimalisht me 40% brenda 10 viteve.

Aleanca e Grave Deputete për legjislaturën e IX, përbëhet nga gratë deputete të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste, Grupi “Demokrat”, Grupi “I pavarur”, Grupi “Demokraci dhe drejtësi” dhe gra deputete të pavarura. Aktualisht, Aleanca e Grave Deputete përbëhet nga 36 gra. (*Shtojca nr. 1*)

II. VEPRIMTARIA E AGD-SË GJATË VITIT 2020

a) Veprimtari me karakter legjislativ

Aleanca e Grave Deputete gjatë vitit 2020 ka zhvilluar aktivitete të ndryshme si seanca dëgjimore, workshop-e, trajnime si dhe pjesëmarrje në aktivitete sensibilizuese duke luajtur një rol aktiv në përmirësimin e ligjeve me ndjeshmëri gjinore të cilat miratohen në Kuvend për t’i përshtatur ato me standardet më të mira ndërkombëtare.

Më datë 2 shkurt 2020, Aleanca e Grave Deputete në bashkëpunim me Nënkomisionin Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Nënkomisionin për Çështjet Vendore, organizuan një seancë dëgjimore me përfaqësues nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, shoqatat vendore, lidhur me funksionimin e Mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Kjo seancë dëgjimore pati si agjendë diskutimi evidentimin e problematikave që shfaqen në praktikë, si dhe në dhënien e rekomandimeve për mënyrën e funksionimit të këtyre mekanizmave për të parandaluar dhe trajtuar rastet e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje.

Më datë 2 qershor 2020, Aleanca organizoi një seancë dëgjimore me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me temë: “Dhuna në familje gjatë periudhës së pandemisë Covid-19”. Gjatë seancës dëgjimore u prezantuan masat e marra nga institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, përshtatur me situatën e COVID-19. Disa nga masat e marra janë të tilla si: miratimi i një protokolli me urdhër ministri për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktime e mbijetuara të dhunës në familje dhe për viktimat e mbijetuara nga trafikimi; miratimi i një udhëzimi për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë; hartimi i rregullores së brendshme për funksionimin e qendrës për menaxhim e krizës së dhunës seksuale për situatën COVID-19.

Gjatë kësaj seance dëgjimore deputetët pjesëmarrës ngritën pyetje dhe diskutuan për masat e marra nga institucionet përgjegjëse, bashkëpunimin mes tyre në lidhje me trajtimin dhe me ndjekjen e rasteve të dhunës në familje, rolin e koordinatorit vendor, funksionimi i policimit në komunitet, efikasiteti i zyrave të shërbimeve sociale vendore, funksionimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes etj.

Më datë 22 qershor 2020 u zhvillua një seancë dëgjimore e përbashkët me Nënkomisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Nënkomisionin Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, ku u diskutua së bashku me UN Women Shqipëri për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në zgjedhje. Znj. Vasilika Hysi pasi dëgjoi dhe vlerësoi prezantimin dhe sugjerimet në këtë dëgjuesë, në fjalën e saj shtoi duke sjellë një informacion të ri : “Kuvendi është duke zbatuar një projekt të rëndësishëm me agjencinë zviceranë në bashkëpunim me dy organizatat OSBE dhe UN Women lidhur me edukimin ligjor të publikut në zgjedhje”, përfundoi znj. Hysi e cila propozoi që këto ndryshime të diskutohen dhe në komisionin e reformës zgjedhore, ku disa deputete janë dhe anëtare. Deputetja, Elona Gjebrea në fjalën e saj, falënderoi dhe vlerësoi dy ekspertet për propozimet e parashtruara si dhe shtoi se ata mund të kenë një bashkëpunim në nivel kombëtar.

Seanca dëgjimore vijoi me pyetje dhe diskutime nga anëtarët e këtij komisioni, ku deputetja znj. Klotilda Bushka u ndal në disa propozime konkrete si parimi i barazisë gjinore dhe risinë e çështjeve dhe mekanizmave konkrete të propozuara, për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna, në zgjedhje. Duhet të merren nisma, që mund ta realizojnë këtë qëllim, duke i paraqitur tek ekspertët përkatës që po merrem me komisionin”, shtoi deputetja Bushka.

Më 29 qershor 2020, Aleanca e Grave Deputete i paraqiti Byrosë së Kuvendit për miratim Program - Veprimin “Për një Kuvend të ndjeshëm gjinor”. Programi i Veprimit “Për një Kuvend të Ndjeshëm Gjinor”, ka parashikuar 6 prioritete, të cilat janë zbërthyer në 18 objektiva për realizimin e të cilave janë parashikuar një numër i madh aktiviteteve që janë planifikuar të zhvillohen gjatë periudhës 2020-2021, si dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e këtij Programi, monitorimi e kontrolli i progresit të kryer dhe afatet e realizimit. Duke qenë një dokument kuadër,

një pjesë e aktiviteteve do të zhvillohen në mënyrë periodike në çdo fillim viti, ose çdo fund sesioni parlamentar.

Prioritetet e këtij programi janë si më poshtë:

1. Legjislacioni i ndjeshëm gjinor;
2. Mbikëqyrja e ndjeshmërisë gjinore;
3. Përfaqësimi gjinor;
4. Organet e barazisë gjinore;
5. Parlamenti si punëdhënës me ndjeshmëri gjinore;
6. Programi i planifikimit strategjik/ veprimet me ndjeshmëri gjinore.

Gjithashtu po në këtë mbledhje Byroja e Kuvendit miratoi dhe Kalendarin e Veprimtarisë për periudhën qershor – dhjetor 2020 të Aleancës së Grave Deputete.

b) Pjesëmarrje në workshop-e dhe trajnime

Gjatë vitit 2020, gratë deputete kanë marrë pjesë në disa sesione trajnimi dhe workshop-e të organizuara me mbështetjen e organizatave vendase dhe ndërkombëtare.

Më datë 3 -4 mars 2020, Aleanca e Grave Deputete mori pjesë në një trajnim dy ditor “Gratë në politikë”. Një nismë kjo e mbështetur edhe nga “Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje”, drejtuar nga znj. Edlira Çepani, në bashkëpunim me NDI-në, mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, si dhe nga Instituti i Studimeve Politike, drejtuar nga z. Afrim Krasniqi, mbështetur nga ambasada holandeze në Tiranë.

Gjatë këtij diskutimi u vlerësua ndikimi i gruas në politikë, vendimmarrja e tyre si dhe barazia gjinore e më së shumti u ndalën dhe në fuqizimin i profilit të lidërshipt, grua.

Lidërshipti efektiv i bazuar mbi objektiva të qarta dhe mbi një profil të fortë lidërshipti. Ky sesion do të përfshijë: Kryerja e vlerësimit personal; zhvillimi i një narrative të lidërshipt në publik; rëndësia e bio-s dhe ndërtimi i një profili; krijimi i një platforme; krijimi i zërit dhe i mesazhit dallues tek gratë.

Më 29 qershor 2020, një sesion trajnimi online me temë “Përfaqësimi dhe lidërshipt-i në kohë krize. Komunikimi me zgjedhësit: Mësimet nga pandemia Covid-19”. Të pranishme në këtë trajnim online ishin gra deputete pjesë e Aleancës së Grave Deputete. Trajnimi u përshëndet nga Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë znj. Yuri Kim, zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi dhe znj. Elona Gjebrea Hoxha zëvendëskryetare e Aleancës. Ky sesion trajnimi u drejtua nga dy lektore znj. Karolina Leakovic (Deputete në Parlamentin e Kroacisë) dhe znj. Frieda Arenos (Menaxhere Programi NDI Washington).

Znj. Edlira Çepani, koordinatore kombëtare e Rrjetit të Grave Barazi në Vendimmarrje theksoi se janë bërë hapa të rëndësishme për të rritur numrin e grave në vendimmarrje dhe se gratë kanë nevojë për mbështetje dhe prandaj nisi dhe Akademia e Leadership-it për të mbështetur gratë deputete.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Yuri Kim gjatë fjalës së saj përshëndetëse theksoi se gratë deputete duhet të shfrytëzojnë këtë Akademi për të ndërtuar rrjetin e tyre sepse ky është një aspekt i rëndësishëm për të bërë ndryshime. Gjithashtu, znj. Kim nënvizoi se është e rëndësishme që gratë deputete të qëndrojnë të lidhura.

Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi shprehu mirënjohjen për këtë mundësi dhe se ky takim është i rëndësishëm për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid -19. Gjatë fjalës së saj, ajo nënvizoi se Parlamenti shqiptar reagoi në mënyrë të menjëhershme për të punuar online. Fokusi i Parlamentit ka qenë miratimi i disa akteve të lidhura me të miturit, gratë, viktimat e dhunës në familje kanë qenë prioriteti ynë. Znj. Hysi theksoi se parlamenti shqiptar ka qenë modeli më i mirë në rajon.

Në fjalën e saj përshëndetëse, znj. Elona Gjebrea Hoxha, zëvendëskryetare e Aleancës së Grave Deputete shprehu se si rezultat i bashkëpunimit mes grave deputete u miratua Kalendari i Veprimtarisë së AGD-së për vitin 2020 dhe Programi i Veprimit “Për një Parlament të Ndjeshëm Gjinator”. Znj. Gjebrea nënvizoi se këtë vit, Aleanca me punën e saj do të mbështesë nëpërmjet objektivave të qarta masat për dhunën në familje, fuqizimin ekonomik të grave, dhe pse jo edhe përfshirjen e burrave. Gjithashtu në fjalën e saj znj. Gjebrea u ndal në çështjen e kuotave gjinore duke cilësuar se kuotat gjinore janë të rëndësishme në vende si yni ku lufta me burrat është një sfidë.

Trajnimi vijoi më tej në trajtimin e temës së parë “*Përshatjet e reja parlamentare gjatë Covid -19*” nën drejtimin e ekspertes Frieda Arenos e cila u ndal në disa çështje si: ndikimi i Covid-19 tek gratë, rëndësia e komunikimit në kohë krize, mënyrat e komunikimit në Covid-19, planifikimi strategjik i komunikimit etj.

Në pjesën e dytë, trajnimi vijoi me trajtimin e temës: “*Gratë deputete dhe përgjegjshmëria gjinore në kuadër të pandemisë COVID-19*” nën drejtimin e deputetes kroate znj. Karolina Leakovic. Gjatë këtij sesi znj. Leakovic u ndal në legjislacionin dhe zhvillimin e politikave gjatë Covid-19 dhe gratë e deputetëve dhe organizimi i komunitetit në pandeminë COVID-19.

Më pas trajnimi vijoi me një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh mes lektoreve dhe grave deputete gjatë të cilit gratë deputete shkëmbyen eksperiencat dhe sfidat e tyre për punën parlamentare gjatë periudhës së Covid -19.

Ky trajnim online u organizua me mbështetjen e Rrjetit të Grave Barazi në Vendimmarrje në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI) dhe mbështetjen e Ambasadës Amerikanë në Tiranë.

Më datë 12 tetor 2020, Aleanca mori pjesë në një sesion informimi/diskutimi online me temë: “Barazia Gjinore dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) -Matja e efikasiteti i arritjes së integritetit të barazisë gjinore dhe OZHQ (SDGs).” Gjatë këtij sesioni përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së dhe të Zyrës së Kombeve të Bashkuara prezantuan rëndësinë e perspektivës gjinore dhe rolin e saj si një domosdoshmëri për arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe rolin e Parlamentit në këtë drejtim. Gjatë diskutimit, deputetet prezantuan hapat e ndërmarra dhe punën e kryer nga Kuvendi i Shqipërisë mbi integrimin gjinor dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, deputetet paraqitën propozime konkrete lidhur me hapat në të ardhmen në sesione të tilla informuese. Ky sesion informues u organizua nga Prezenca e OSBE-së Tiranë dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara në Tiranë.

Më datë 24 – 25 nëntor 2020, Aleanca e Grave Deputete mori pjesë në një trajnim dy ditor online me fokus komunikimin publik dhe fuqizimin e rolit të grave në zgjedhjet parlamentare. Ky trajnim u zhvillua nën drejtimin e ekspertit z. Johan Hamels.

Dita e parë e trajnimit u fokusua në trajtimin e temës “Listat e hapura dhe kandidimi i grave dhe vajzave”. Në këtë sesion ishin të ftuara tre gra deputete: znj. Gudrum Kugler, deputete në Austri, znj. Inka Hopsu, deputete në Finlandë dhe znj. Mimoza Kusari Lila, deputete në Kosovë. Deputetet e ftuara ndanë me Aleancën e Grave Deputete, eksperiencat e tyre, vështirësitë dhe sfidat e të qenurit grua deputete si dhe diskutuan lidhur me rëndësinë e profilizimit të grave në një fushë të caktuar si dhe mbështetja ndaj njëra - tjetrës. Më tej, eksperti Johan Hamels prezantoi mënyrën e mbledhjes së fondeve për fushatën zgjedhore. Në përfundim, gratë deputete pjesëmarrëse diskutuan dhe ndanë eksperiencat e tyre me të ftuarit.

Dita e dytë e trajnimit online u ndal në temën “Listat e hapura dhe aksesit në financat politike për kandidatet gra dhe vajza”. Në këtë sesion ishin të ftuara dy gra deputete: znj. Mirjam Sterk deputete në Hollandë dhe znj. Miriam Lexmann, deputete nga Sllovakia. Ato ndanë eksperiencat e tyre për mënyrën e mbledhjes së fondeve si dhe eksperiencat e tyre personale si deputete gra. Më tej, gratë deputete u ndanë në grupe të vogla pune. Në vijim, eksperti Johan Hamels prezantoi disa hapa konkretë për mënyrën e mbledhjes së fondeve.

Ky trajnim u zhvillua në kuadër të sesionit të katërt dhe të pestë të Akademisë së Liderit duke përfunduar pjesën teorike të trajnimeve dhe për të vijuar më tej me sesione trajnimi individuale të grave deputete pjesë e Aleancës së Grave Deputete. Trajnimi u organizua nga Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Demokraci (NDI) dhe mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri.

c) Veprimtari ndërgjegjësuese

Aleanca e Grave Deputete, sikurse çdo vit tjetër, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë veprimtarive sensibilizuese në kuadër të javës së parandalimit të kancerit në qafën e mitrës dhe Ditës Botërore kundër Kancerit.

Më datë 22 tetor 2020, Aleanca e Grave Deputete bashkë me YWCA Albania, organizuan ditën e sotme një aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të fushatës kundër kancerit të gjirit. Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë u solidarizuan duke blerë maska dhe çanta të YWCA, për të kontribuar në këtë nismë ndaj grave që përballen me kancerin e gjirit. Të ardhurat e grumbulluara nga kjo nismë do t'i shërbejnë YWCA-së për vazhdimësinë e këshillimit psikologjik online falas për gratë me kancer në gj. YWCA Albania është e angazhuar prej 12 vitesh në çështje të rëndësishme për gratë dhe vajzat për ndërgjegjësimin, parandalimin, kujdesin ndaj vetes si dhe mbështetjen gjatë përballjes me kancerin e gjirit.

Gratë deputete u angazhuan në organizimin e takimeve sensibilizuese në disa qytete të vendit, për të gjitha gratë dhe vajzat me kryefjalë bërjen e kontrollove periodike, për të luftuar në kohë këtë sëmundje. Gjatë takimeve sensibilizuese gratë deputete theksuan nevojën për të rritur ndërgjegjësimin tek çdo grua dhe vajzë për të bërë kontrollin e gjirit, për të gjetur guximin për t'u përballur me sëmundjen e vështirë, sepse lufta kundër kancerit të gjirit mund të fitohet, prandaj kontrolli periodik dhe diagnostikimi i hershëm janë shumë të rëndësishëm për jetën dhe shëndetin e të gjitha grave.

ç) Pjesëmarrje në takime të tjera

Më datë 4 dhjetor 2020, Aleanca mori pjesë në një seancë dëgjimore online “Ndikimi i Pandemisë Covid -19 në Çështjet e Grave” organizuar nga Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Në takim morën pjesë edhe organizata të shoqërisë civile që trajtojnë dhunën me bazë gjinore në Shqipëri. Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi edhe Presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, z. Deans adresuan përparimin e bërë në fushën e zbatimit të Konventës së Stambollit dhe vëmendjen për një angazhim dhe kontribut më të madh të qeverisjes vendore kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, sidomos për strehimin, punësimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Kjo dëgjese u organizua në kuadër të nismës së Presidentit të Asamblesë Parlamentare të KiE, z. Rik Daems, për forcimin e bashkëpunimit mes parlamenteve kombëtare gjatë krizës aktuale COVID-19.

Qëllimi i kësaj nisme është që të gjitha parlamentet e vendeve anëtare të KiE të organizojnë dëgjesa në komisionet e përhershme parlamentare kushtuar tematikave të veçanta mbi ndikimin dhe pasojat e pandemisë COVID-19.

Më datë 9 dhjetor 2020, u zhvillua tryeza “Bashkëpunimi Ndërinstitucional për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore” organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Në këtë tryezë mori pjesë znj. Vasilika Hysi, nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Elona Gjebrea Hoxha nënkryetare e AGD-së dhe znj. Eglantina Gjermeni, nënkryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas dhe znj. Klotilda Bushka, deputete në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas.

Gjatë kësaj tryeze u diskutua progresi që ka bërë vendi ynë në kuadër të miratimit të ligjeve në këtë fushë. Po nga ana tjetër u diskutua rritja e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, si dhe nevoja e rritjes së bashkëpunimit mes institucioneve në nivel vendor dhe qendror, rritja e aftësive profesionale të punonjësve të angazhuar në trajtimin e këtyre çështjeve.

Në cilësinë e nënkryetares së AGD-së, znj. Gjebrea prezantoi angazhimet dhe veprimtaritë e kryera nga AGD-ja në luftën kundër dhunës ndaj grave si dhe kërkoi në emër të Aleancës rritjen e bashkëpunimit me prokurorinë si dhe institucionet e tjera të specializuara përmes zhvillimit periodik të tryezave të tilla.

Kjo tryezë shërbeu për të analizuar hapat e ndërmarrë vitet e fundit në kuadër të përafrimit të legjislacionit penal material dhe procedural, zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore, por edhe për të koordinuar punën mes institucioneve për parandalimin e mëtejshëm të këtyre fenomeneve.

Më datë 16 dhjetor 2020, Aleanca mori pjesë në një takim online gjatë të cilit u bë prezantimi i raportit nga UNFPA “Analiza e Politikave të Përgjegjshme Gjinore për Familjen në Shqipëri”. Prezantimi i kësaj Analize u organizua nga UNFPA në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Nënkomisionin Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas si pjesë e aktiviteteve dhe në përputhje me objektivat e projektit rajonal “Më shumë zgjedhje: Politikat e Përgjegjshme Gjinore për Familjen për Sektorin Privat në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi” zbatuar nga UNFPA dhe mbështetur financiarisht nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA).

Gjatë vitit 2020, AGD-ja vijoi bashkëpunimin me institucione shtetërore si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme etj. Po ashtu bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile vendase dhe ndërkombëtare, ekspertë dhe grupe interesi ka vijuar edhe gjatë vitit 2020. AGD-ja ka bashkëpunuar me organizata si : OSBE, Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje, National Democratic Institute (NDI), Instituti i Studimeve Politike, UN Women, UNFPA, YWCA Albania, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta etj.

Shtojca 1

1. Adelina Rista
2. Almira Xhembulla
3. Antoneta Dhima
4. Amra Barova
5. Ardiana Jaku
6. Artemis Malo
7. Aurora Mara
8. Blerina Gjylameti
9. Ediola Braha
10. Edlira Bode
11. Edlira Hyseni
12. Eglantina Gjermeni
13. Elda Hoti
14. Elena Xhina
15. Elona Hoxha
16. Elisa Spiropali
17. Enada Kapllani
18. Ermonela Valikaj (Felaj)
19. Evis Kushi
20. Fatjona Dhimitri
21. Klodiana Spahiu
22. Klotilda Bushka (Ferhati)
23. Lindita Nikolla
24. Majlinda Halilaj
25. Milva Ekonomi
26. Mimi Kodheli
27. Mirela Kumbaro (Furxhi)
28. Ogerta Manastirliu
29. Olta Xhaçka
30. Reme Lala
31. Rudina Hajdari
32. Senida Mesi
33. Suzana Topi
34. Tatiana Piro (Nurçe)
35. Vasilika Hysi
36. Vilma Bello